

Myzafere Mustafa

## MBI DISA VEÇORI ARTISTIKE TË KËNGËVE TË DASMËS

Këngët e dasmës nuk pasqyrojnë vetëm jetën që ka të bëjë me dasmën, me periudhën që i paraprin ose që pason, por me jetën e njeriut në përgjithësi. Ato janë reflektim i dokeve dhe i zakoneve të popullit, i mentalitetit dhe i virtyteve të tij, i marrëdhënieve shoqërore dhe i kushteve të jetës, i krenarisë dhe i qëndresës së njeriut tonë nëpër kohë, i aspiratave për një jetë më të mirë e më të begatshme.

Nëpërmjet varianteve të shumta që zënë fill me momentin kur mësiti shkon ta kërkojë vajzën, pastaj gjatë vetë procesit të dasmës si dhe më vonë këndohen shumë gjëra që lidhen me jetën e njeriut, duke filluar nga kujtimet e fëmijërisë, të djalërisë, të periudhave të tjera e deri të pleqëria, me shumë nuanca e detaje që nuk i ndeshim në krijimet e tjera të poezisë gojore lirike shqiptare.

Në këto këngë përjetësohen artistikisht fenomenet e ndryshme të jetës në përgjithësi, marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, dukuritë e natyrës, raportet familjare dhe njerëzore ato ndërmjet të rinjve që lidhin bashkë fatin e tyre, punët në shtëpi dhe në arë — shumëçka që e cilëson jetën e njeriut tonë. Kjo bie në sy në të gjitha llojet e këngëve të dasmës, në të gjitha këngët që përcjellin etapat e ndryshme të këtij riti të rëndësishëm familjar.

Këngët e dasmës karakterizohen me gjerësinë tematike e motivore, me drejtpërdrejtshmërinë e tyre në periudha e momente të caktuara të zhvillimit të ritit të dasmës. Nëpërmjet krijimeve del qart edhe vlera artistike e tyre. Me fjalë të tjera, në shumicën e tyre jo vetëm që shprehen të dhënat që lidhen drejtpërdrejt me ritin e dasmës dhe me detajet e etapat përkatëse, po dëshmohet për vlerat letrare e artistike të tekstit të këngëve të dasmës, për efektin estetik që bëjnë ato në dëgjuesin dhe lexuesin, që është cilësi e veprave letrare artistike.

Duhet theksuar se vetë tematika e këtyre këngëve, motivet dhe mënyra e ekzekutimit, që është e lidhur ngushtë me ritin e dasmës, me kontekstin e situatës, ka kushtëzuar edhe strukturën e tyre.

Këngët janë të kushtëzuara tematikisht dhe kontekstualisht meqë këngëtarët i ekzekutojnë në një atmosferë të veçantë, qoftë kur ato këndohen në shtëpi të djalit, qoftë kur këndohen në shtëpi të vajzës. Pra, meqenëse këngët e dasmës janë të lidhura me fenomene që kryesisht pasqyrojnë çështje të jetës së përditshme, siç është në rastin tonë martesë, ato edhe nuk largohen nga ai realitet. Përkundrazi e shprehin atë nga shumë kënde e aspekte. Prandaj këngët e dasmës nuk i cilëson dimensionin i fantazisë krijuese siç ngjan në këngët e tjera, ku mundësia shprehëse artistike është më e ndieshme dhe fuqia krijuese shprehet më dukshëm. Në këngët e dasmës mbizotëron nevoja për komunikim të drejtpërdrejtë me fenomenet, dukuritë, për t'i shfaqur sa më qartë preokupimet, qëndrimet, synimet e ndryshme etj. Qëllimi kryesor i tyre është efekti sa më i madh komunikues i atypëratyshëm, prandaj ato karakterizohen me fenomenin e improvizimit, jo në kuptimin e imitimit të plotë, por në bazë të tematikës përkatëse, të strukturës e të modeleve tradicionale. Situata tipike, detaji që mund të mos ketë ndodhur në ndonjë rast tjetër, në shtëpi të djalit ose në shtëpi të vajzës, kushtëzon që aty për aty të lindë kënga përkatëse. Kjo nuk do të thotë se nga lindja „e shpejtë” krijohet kënga e dobët. Përkundrazi fenomeni i improvizimit, në këngët e dasmës në përgjithësi, sikurse edhe te këngët që këndohen në shtëpi të vajzës, është veçori e tyre.

Shumica e këngëve të dasmës me vargun e parë theksojnë elementin esencial të objektit artistik. Në raste të shpeshta, nëpërmjet strukturës dialogjike, realizohet kënga si tërësi, shfaqen idetë e ndryshme dhe jepen informacione të caktuara.

Kur bëhet fjalë për vlerën artistike të këngëve të dasmës pra për dimensionin artistik të tyre, duhet theksuar se këndimi dhe konteksti i situatës së ritit përkatës si dhe defitë si instrument që i përcjell këngët që këndohen në shtëpi të djalit, janë elemente qenësore të ekzistimit të këtyre krijimeve. Për këtë arsye vlera relative e disa këngëve të dasmës si tekste „kompensohet” me këndimin, me zërin, me defin (sidomos në shtëpinë e dhëndrit). Poashtu edhe shtrirja e pajës, ngjitja e kënasë, prania e krushkave, hedhja e grurit etj., i bën këto krijime më të drejtpërdrejta dhe më funksionale për situatën konkrete. Prandaj kurdoherë ato duhet të shqyrtohen në një kushtëzim dhe reciprocitet të disa elementeve qenësore të interpretimit, të ekzistimit të tyre.

Megjithëkëtë edhe në këto këngë teksti paraqet elementin më të rëndësishëm të vlerës artistike dhe të fuqisë komunikuese të tyre. Kjo lidhet drejtpërdrejt me vetë gjuhën e këtyre këngëve. Meqenëse qëllimi i këtyre krijimeve është komunikimi i drejtpërdrejtë, i qartë dhe me efekt të atypëratyshëm, atëherë në to përdoret një gjuhë kryesisht e karakterit informativ, pa atë forcën e gjuhës poetike që përdoret në këngë të tjera lirike e epike. Këngët e dasmës përdorin atë gjuhë që realizon sa më mirë qëllimin informativ komunikues. Pra, këngëtarët më tepër zbatojnë parimin çka të thuhet sesa

si të thuhet, Këtë e arsyeon edhe vetë gjuha, që është kryesisht ajo e komunikimit të zakonshëm.

Megjithatë krijueset popullore arrijnë të krijojnë këngë me vlera të konsideruara artistike, me një gjuhë të pasur poetike. Shprehjet dhe modelet e të shprehurit dëshmojnë për vlerat letrare artistike të tyre. Këto vlera mund të vërehen edhe kur bëhet fjalë për këngët si tërësi, për tekste vërtet të plota, por edhe për mjetet e ndryshme që këngëtarët i përdorin në thurjen e vargjeve, të sintagmave poetike, krahasimeve, metaforave, epiteteve, etj. Në këngët e dasmës përdoren përsëritjet që janë karakteristikë e gjithë poezisë gojore. Sikurse edhe dialogu që është element i rëndësishëm i strukturës së këtyre këngëve, përsëritjet u japin këtyre një intensitet dhe ritëm të caktuar, i bëjnë ato më dinamike dhe efekti i tyre komunikues bëhet shumë më i madh.

Kënga që po sjellim (nga Ljarja e Krajës) dëshmon për modelin, për strukturën e krijimit, për gjuhën dhe për realizimin artistik, për një tërësi harmonike e të plotë. Modeli që është tradicional dhe që ruhet gjatë trajtimit të objektit artistik të këngës ka bërë të mundshme intensifikimin e shprehjes dhe të ritmit, të idesë dhe të porosisë. Përsëritjet janë në funksion të ngushtë me modelin dhe me tërësinë e strukturës.

*Atje posht-e ne 'i mëhallë  
 martohej një vashë e barllë.  
 Shkonjin krushqit për m'e marrë.  
 — Nisu, nuse, dalkadalë,  
 nisu, nuse, motra jonë!  
 — Nisun jam, po dalë s'po kam,  
 harrova myhyrin-o,  
 shenj në gisht të sem vëlla.  
 — Nisu, nuse, dalkadalë,  
 nisu, nuse, motra jonë,  
 se myhyrin na ta çojmë!  
 Atje posht-e ne 'i mëhallë  
 martohej një vashë e barllë.  
 Shkonjin kushqit për m'e marrë.  
 — Nisu, nuse, dalkadalë,  
 Nisu, nuse, motra jonë!  
 — Nisun jam, po dalë s'po kam,  
 harrova gjerdanin-o,  
 shenj në fyt të seme motër.  
 — Nisu, nuse dalkadalë,  
 nisu, nuse, motra jonë,  
 se gjerdanin na ta çojmë!<sup>1</sup>*

<sup>1</sup> Arkivi i Institutit Albanologjik, këndoi: Kolë M. Bitraj, Ljare, Krajë, shënoi: Ismail Doda, Arbnesht, Krajë.

Kënga pastaj vazhdon me theksimin e elementeve të tjera si jelekun etj., për të vazhduar përsëritjet që lidhen me pohimin e nuses se „nuk ka të dalë” — me atë vend e me ata njerëz që e lidhin aq shumë gjëra, duke i përmendur ato një nga një. Kjo mënyrë e krijimit, sidomos nëpërmjet dialogut, është një nga më të shpeshtat ku bien në sy edhe elementet e shprehjes artistike, por para së gjithash bie në sy tërësia e këngës.

Për funksionin e dialogut dhe të strukturës së këtij lloji të lirikës familjare, për gjuhën e zgjedhur dhe të ngritur poetikisht dëshmon edhe kënga — *Sytë e zez të mitë me lumshin* nga Tivari, ku këngëtarja ka arritur të krijojë një këngë të plotë artistike, që këndohet në shtëpinë e vajzës. Dialogu i fillimit vetëm sa shërben për të depërtuar më thellë në strukturën gjuhësore shprehëse të këngës.

— *Ka' po vini, dorakinja?*  
 — *Na nuk jena dorakinja,*  
*por jena krushq për nuse.*  
 — *Për të bi të kuj po shkoni?*  
 — *Për të binë e Regji-pash's.*  
*Aty vetë Regjin s'e gjenë,*  
*por e gjen-e Regja-zanë.*  
 — *E pafatmja, bija eme,*  
*kush ta vishën gunjin-murrë,*  
*kush ta njishen brez-argjentin,*  
*kush ta dredhën cilpur-hollën?*  
*Lena nolli me nafakë —*  
*erdh' i vllaji në mjesnatë*  
*e ja vishi gunjin-murrë*  
*e ja njishi brez-argjentin*  
*e ja dredhi cilpur-hollën.<sup>2</sup>*

Dimensionin artistik e ndeshim edhe në shumë këngë të tjera të këtij lloji. Kështu në këngën *Erdhe nuse erdhe* nëpërmjet krahasimeve shumë funksionale jepet një tablo sugjestive me forcë artistike. Nëpërmjet inversionit arrihet një efekt i madh estetik.

*Ja tek vjen një re e bardhë,*  
*Ajo s'është re e bardhë,*  
*Po janë krushqit me palë;*  
*Ja tek vjen një re e kuqe,*  
*Ajo s'është re e kuqe,*  
*Po janë krushqit me nuse.<sup>3</sup>*

<sup>2</sup> Arkivi i Institutit Albanologjik, këndoi: Mrikë Gjikuçiç, Tivar 1969, shënoi: Fran Zef Jankaj, Ljare.

<sup>3</sup> Instituti i Folklorit, 250, *Këngë popullore dasme*, Tiranë 1966, f. 79.

Edhe pse theksuam se në shumicën e rasteve këngët e dasmës nuk përdorin atë gjuhë simbolike e metaforike që ka një dimension më të ndjeshëm dhe është më prezente në këngët e tjera lirike, pastaj në baladat e sidomos në këngët kreshnike, shembulli që po sjellim e mohon këtë. Në tetë vargjet këngës së ardhshme është përdorur një gjuhë simbolike, ku manifestohet një fuqi shprehëse e jashtëzakonshme, ku janë krijuar e gërshetuar krahasime e metafora (hëna me rreze në dorë, hëna me rreze në gji), që vetëm krijuesit e rrallë mund t'i thurin dhe të funksionalizojnë në këtë mënyrë në veprat e tyre. Ato nuk mbesin prapa krijimeve me vlera të larta artistike të autorëve të letërsisë së shkruar.

*Nisim, nisim diellin,  
Të na marri hënë,  
Hëna me rreze në dorë,  
Na ndritoi këtë oborr.  
Nisim, nisim diellin  
Të na marri hënë,  
Hëna me rreze në gji,  
Na ndritoi këtë shpi!*<sup>4</sup>

Niveli i lartë poetik i këngëve të dasmës shihet edhe në disa këngë që i ka mbledhur De Rada, dhe i ka botuar në *Rapsodi të një poeme shqiptare* më 1866. Fragmentin që po japim më poshtë nga pjesa me titull *Këngë dasme*, nuk dëshmon vetëm për gjuhën e lartë poetike, për vargun e plotë, për fjalët, që e bëjnë poezinë popullore arbreshe ndër pjesët më cilësore të krijimtarisë gojore shqipe në përgjithësi, por edhe për kuptimin e thellë që del, për të gjitha ato elemente që e cilësojnë një vepër të njemëndtë letrare - artistike. Metaforat si *vashë e dlirë, mollë e pambjellë (ke shtën')* rrëniat *pa dhe, lulzoi hija*, epitetet si *faqemollëzën, mezpurtekëzën, buzëqeshur(ën)* etj. dhe shprehjet e tjera dëshmojnë për vlerat e kësaj kënge dhe të poezisë gojore arbëreshe në përgjithësi.

*Gratë: O nuse, vashë e dlirë,  
E kujt je, moll'e pambjellë,  
Ke shtën' rrëniat pa dhe?*

*Vasha: Po, asnjeri s'më ka vaditur,  
Vetvetiu lulzoi hija,  
Djelli vet' më zbukuroi.*

*Burra jashtë: Dallëndyshe xverk e bardhë,  
Hape derën e na dil,  
Se te erdh trimi në derë,  
Po troket të të përgjunjet.*

<sup>4</sup> Instituti i Folklorit, 250, *Këngë popullore dasme*, Tiranë 1966, f. 124.

*Gru brenda: Qeti, shokë, se është e zënë,  
T'linat i kemi në finjë,  
Bukët i kemi në furrë,  
Sa t'i nxjerrim, pastaj vjen.*

*Burrat jashtë: Po ti trim e zoti dhëndër,  
Mos me ec ashtu i trembur,  
Se nuk vete të luftosh,  
Po më vete të rrëmbesh  
Atë vashën buzëqeshur,  
Atë faqemollëzën,  
Atë mezpurtekëzën,  
Plot me for' përpara nga,*

*Gru brenda: Me ç'erdh koha dhe po nise,  
Paç ti nur, o motra ime,  
Posi dielli kur na del,  
Porsi vera nëpër qelqe,  
Porsi peta në mesallët,  
Nisu, e lumma motr e ime...<sup>5</sup>*

Krahasimi është ndër figurat mjaft të shpeshta në këngët e dasmës. Nëpërmjet tij këngëtarja shpreh botën e vet të brendshme, qëndrimin ndaj fenomeneve, ndaj njerëzve, vë në pah bukurinë e nuses, të djalit, gëzimin, kënaqësinë, por edhe hidhërimin, pezmin, pakënaqësinë etj. Sidomos krahasimi përdoret dendur kur bëhet përshkrimi i bukurisë së vajzës-nuses, pastaj dhëndrit, por edhe të të pranishmeve të tjera.

Krahasimet e këngës *Nusja jonë n'oborr* janë ndër të shumtat dhe në të vërtetë shprehin esencën e strukturës tekstore dhe kuptimore, ato janë funksionalizuar nga krijuesja popullore dhe i japin krijimit një vlerë të veçantë.

*Nusja jonë n'oborr  
Shtatin si vaporr,  
Nusja jonë në derë,  
Belin si qemerë,  
Nusja jonë në shtëpi,  
Shtatin si selvi.  
Ka ra hana në çardak,  
Shkëlqen nusja nan duvak  
Ka ra hana në sefere,  
Shkëlqen nusja nan velle.<sup>6</sup>*

<sup>5</sup> Poezi popullore arbëreshe, mbledhur e përshtatur dhe vënë në gjuhën e sotme nga Ziaudin Kodra, Tiranë 1957, f. 147.

<sup>6</sup> Instituti i Folklorit, 250, *Këngë popullore dasme*, Tiranë 1966, f. 41.

Në këngën *Ngjitja Hanës t'bardht e ftyrës*<sup>7</sup> nga Karaçeva e Kamenicës këngëtarja popullore ka përdorur një mori krahasimesh të qëlluara. Çika-nuse, Hana, krahasohet, me shumë fenomene e objekte të natyrës që janë të lidhura ngushtë me jetën si dhe me ambientin ku ka jetuar e ku është rritur.

*Ngjitja Hânës ngjitja Hanës  
t'bardht e ftyrës,  
Po zdit Hâna si rrezja e dritës.  
Ftyra e Hânës dritë po ban,  
ka kapërcye çikat e katunit tanë.  
Ngjitja Hanës, ngjitja Hanës  
t'kuqt e faqës  
Na u ka ba Hana  
si dranafil i kaçës.*

Është kjo një simbolikë që shfrytëzohet shpesh nga krijuesi gojor. Hëna si figurë poetike vërehet në shumë krijime të këtij lloji prania dhe stabiliteti i së cilës shihet edhe në këtë krijim. Në të vërtetë, Hëna në këtë këngë nuk është vetëm në funksion të emrit, ajo është simbol i nuses nga i cili pastaj dalin krahasimet e qëlluara. Ky shembull vetëm e forcon mendimin se krahasimi është njëri ndër mjetet më të shpeshta të shprehjes së figurshme poetike të kësaj krijimtarië. Atë këngëtarja e gjen në jetën e përditshme, në ambientin jetësor, në objektet e ndryshme, në dukuritë natyrore etj. Kështu krijuesja veshjen dhe ngjyrat e veshjes i krahason me pamjen dhe me ngjyrat e beharit që lulëzon në pranverë dhe që stolis natyrën mu si veshja nusen, paralelizëm ky i bukur dhe i krijuar me shkathtësi. Edhe pse krijimi është realizuar nëpërmjet përshkrimit figurativ, kënga ka arritur efektin artistik. Bukuria e femrës në këtë krijim korespondon me bukurinë e natyrës.

*Uniu mal të dalë hëna,  
Të stoliset kadëna.  
Të mvishet në të holla  
Të lulëzonjë si molla.  
Të mvishet në të bardha  
Të lulëzonjë si dardha.<sup>8</sup>*

Shumë këngë të dasmës, edhe pse i takojnë një mediumi të caktuar - letërsisë gojore - trajtojnë tematikë të caktuar dhe janë të kushtëzuara nga konteksti shoqëror dhe i situatës si dhe nga riti si pjesë e pandashme e tij, kanë vlera të dukshme letrare artistike,

<sup>7</sup> Instituti Albanologjik i Prishtinës, *Këngë dasme I*, Pregatitur nga Anton Çetta dhe Anton Berisha, Prishtinë 1980. f. 289.

<sup>8</sup> *Këngë popullore lirike*, botim i Institutit të Shkencave, Tiranë 1955, f. 161.

dhe kur janë reflektim i realitetit jetësor, ato e pasurojnë artistikisht atë realitet. Kur janë të kënduara në vetën e parë ato nuk shprehin vetëm dimensionin personal por ngrihen në nivel përgjithësues artistik. Kjo kushtëzon që krijimet e tilla të përvetësohen sa më shumë nga mesi ku lindin si dhe nga midiset e tjera.

*Myzafere Mustafa*

## QUELQUES PARTICULARITÉS ARTISTIQUES DES CHANTS DE MARIAGE

### Résumé

Dans cet exposé, qui traite quelques aspects artistiques des chants de mariage sont présentés le mariage ou la noce et les rites qui l'accompagnent depuis la période précédent les fiançailles, les fiançailles, la préparation du trousseau, la teinture des cheveux avec la kana, le moment solennel où l'on vient chercher la mariée ect. Tous ces moments ou étapes conditionnent le chant autant son thème que sa structure. Bien que les chants de mariage traitent un thème précis ils sont caractérisés par la variété de leurs thèmes et de leurs motifs qui témoignent de leur richesse et de leur valeur littéraire et artistique.

La noce en elle-même et les rites qui l'accompagnent ont fait que dans les chants de ce genre on n'a pas la possibilité de laisser s'exprimer librement la fantaisie créatrice des chanteurs et les possibilités d'expression artistique n'atteignent pas le niveau des autres créations lyriques ou épiques. Toutefois le bon créateur parvient à créer dans le cadre des modèles et de la tradition des chants ayant une valeur artistique manifeste.

Dans les chants de ce genre la langue a un caractère principalement informatif, c'est la langue de communication quotidienne, cependant, ceci n'est pas la particularité de toutes les créations semblables. Un grand nombre de chants ont une langue poétique riche qui se traduit par des comparaisons, des métaphores choisies, des épithètes, des symboles, des hyperboles ect.

L'improvisation est la particularité caractéristique de ces créations, non comme imitation totale, mais comme fonction active et créatrice.

Le dialogue est aussi une particularité caractéristique de ces chants, grâce à lui on parvient à créer un dynamisme dans la structure sémantique et dans le rythme.